REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 881/20
Datë/Datum 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.881/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina- Referues, Goran Milenkovic- Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Ballkan Petrol" SH.P.K. -Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra dhe yndyrna për automjete", me nr. të prokurimit: Vetë financim -20-828-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "K.R.M. Pastrimi" SH.A., më datë: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Ballkan Petrol" SH.P.K. - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra dhe yndyrna për automjete", me nr. të prokurimit: Vetë financim -20-828-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "K.R.M. Pastrimi" SH.A.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues / K.R.M. Pastrimi SH.A/, ti bëj ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me vajra dhe yndyrna për automjete", me nr. të prok: Vetë financim - 20-828-1-1-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. - Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 881/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra dhe yndyrna për automjete", me nr. të prokurimit: Vetë financim -20-828-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "K.R.M. Pastrimi" SH.A., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 28, 53 dhe nenin 109 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.11.2020, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 10.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Ky pretendim ankimorë ka të bëjë me : Një shembull shumë I thjeshtë: Për produktin nr. 10, Antifriz G-12, AK ka kërkuar aprovim nga SHKODA, kërkesë e cila vetëm për një laik nuk nënkupton se është kërkesë e panevojshme dhe diskriminuese. Me sa kemi njohuri nga kontratat për furnizimet e mëhershme, pjesa dërmuese e automjeteve që AK posedon janë kamiona për bartjen e mbeturinave dhe marka SHKODA nuk ka të bëj absolutikisht me pajisjet që posedon AK. Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues në aneksin 1 për pozicionin 10, është:

10 - ANTIFRIZ KONCETRAT (PAKETIMI 1 DERI NE 10 LIT LITER) G-12+ (Afati i prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar në ambalazhim. Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë)

- Litër
- (G12+)SAE J1034 JASO M325
- SKODA TL 774 D SKODA TL 774 F

Antifrizi G-12+ përdoret për motor me ftohje me ujë, në temperatura të larta dhe të ulta, ofrojnë mbrojtje të mirë antikorodive, ruajte të mire të pompës së ujit, puthitësve, etj.

Skema e antifrizëve është lami në vete, mirëpo më së lehti identifikohen edhe në bazë të normave G11, G12, G12+ etj.

G11- përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 1980-1997 .

G12 - përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 1997-2008.

G12+ përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 2008, Prezent .

G13- përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 2008, Prezent .

Specifikim teknik i kërkuar për pozicioni 10- Kolana(SPECIFICATION) SKODA TL 774 D, SKODA TL 774 F, janë shifra të prodhuesit Volks Wagen, prodhues i cili mbërthen në vete prodhuesit të tjerë siç janë Skoda, Audi, Bugati, Lamborghini, Seat, Porshe dhe makineri të renda MAN dhe SCANIA. Po ashtu te pozicioni 10 – Specifikacioni SKODA TL 774D mund të largohet nga specifikacioni pasi që këtë e mbulon SKODA TL 774 F. Antifrizi i cili i përmbushë kërkesat e VË TL 774D dhe TL 774F është i barabartë me kërkesat e MAN M324 dhe MB325, ndërsa aprovimi i produktit siguron që produkti të jetë I kualitetit të duhur dhe është produkt mjaft ordiner që shumë prodhues e posedojnë. Andaj pretendimi i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Ky pretendim ankimore ka të bëjë me: - Fakti tjetër diskriminues dhe i pa arritshëm është se për secilin produkt ka kërkuar: Afati I prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar në ambalazhim nga prodhuesi. Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë. Është absurd të kërkohet që produkti të ketë tape të dyfishtë kur pothuajse asnjë prodhues nuk aplikon tape të dyfishtë për ambalazhimet e tyre në paketim 10L ose me çfarë logjike është kërkuar këtë kriter për yndyrë kur dihet se yndyra zakonisht ofrohet në kanta metali ose plastike dhe tapa e dyfishtë është e pa arritshme për thuajse të gjithë prodhuesit.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se duke marrë parasysh që shumë prodhues nga regjioni i EU-së, ambalazhet në bidonë plastike prej kapacitetit 10 litër e më lartë, i cilësojnë si ambalazhe industrial, dhe për të njëjtin përdoret me një tape të vetme dhe janë të pajisur me puthitës, pra kjo ofron siguri të lartë për rrjedhje, transport etj. Autoriteti Kontraktues në aneksin 1 specifikime teknike të detyrueshme, të kolona "Përshkrimi i shkurtë" për të gjitha pozicionet , 1 deri 16 të korrigjohet dhe të largohet " Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë". Andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Ky pretendim ankimorë ka të beje me: Për pozicionin 5 Vajmotori SAE 5W-40 janë kërkuar 4 aprovime, MB 229.51, Ford WSSM2C917-A, Fiat 9.55535-S2 dhe Fiat 9.955535-H2. Është e palogjikshme që për një produkt të vetëm të kërkohen aprovime nga shumë prodhues të automjeteve Mercedes Ford, Fiat. Nëse hulumtohen certifikatat e prodhuesve më të njohur botëror të vajrave, për vajin me gradacion 5W-40 teksa njëri prodhues nuk mund të gjendet ndonjë produkt i cili ka shumë aprovime për të njëjtin produkt (bashkangjitur disa nga certifikatat e prodhuesve Castrol, Shell e Texaco ku çartë shihet se asnjëri nuk i ka të gjitha 4 aprovimet që I keni kërkuar për vajin SAE 5Ë40). Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar vendimin e OSHP-se me nr. 510/20.

Pra, Autoriteti kontraktues të aneksi 1 specifikime teknike të detyrueshme të kolona "APPROVALS" të korrigjojë dhe të largojë numrin e madhe të aprovimeve për një produkt të kërkohet 1 eventualisht 2 aprovime për produkt. Poashtu, Autoriteti kontraktues të korrigjojë ankesin 1 dhe të kërkon aprovime vetëm për mjete të cilat i posedon. Andaj pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Ky pretendim ankimorë ka të bëjë me: - Për pozicionin nr. 11, yndyrë për lubrifikim, është kërkuar aprovim nga MAN dhe MB. Gjatë përvojës shumë vjeçare, asnjëherë nuk kemi pasur rast që një AK të kërkon aprovime për yndyrë siç është vepruar me këtë rast. Ky është edhe një dëshmi shtesë se po favorizohet një prodhues të caktuar. Ky kriter është tërësisht i panevojshëm dhe diskriminues për shumë prodhues. Eksperti shqyrtues/teknik sqaron në aneksin 1 për pozicionin 11, është kërkuar :

11.YNDYRË PËR LUBRIFIKIM E HOLLË NLGI - 00(PAKETIMI 1 DERI NE 18 kg) Afati I prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar ne ambalazhim nga prodhuesi. Produkti duhet të ketë tape te dyfishtë kg Litium-Kalcium gjysmë fluide për lyerje automatike KP00K-40/ NLGI - Class 00.

Temp -40 grade ne +120 grade celsius

MAN TL 283 dhe MB 264.0

Është e drejtë e Autoriteti kontraktues të kërkojë që YNDYRË PËR LUBRIFIKIM të jetë e aprovuar nga MAN apo prodhuesi Mercedes, për aq kohë sa përdorimi i fundit i yndyrës është në mjetet e paraqitura në kërkesë. Aprovimi për YNDYRË PËR LUBRIFIKIM kërkohet për të garantuar arritjen e kualitetit e cilësisë dhe kërkesave nga MAN dhe MB. Andaj, pretendimi ankimore I operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëj korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna më lartë dhe të bëhet zgjatja e afatit për

dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:

Ndërsa nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues për arsyet si në vijim nga njësia e kërkesës:

Në flotën tonë kemi Skoda të cilat kanë një vlerë mbi 2000 euro dhe duke qenë se janë mjete të reja mundohemi të ndjekim këshillimet teknike të prodhuesit dhe të vazhdojmë të mbajmë të njëjtën standard të produktit si ajo që rekomandon prodhuesi pasi këto mjete vetëm 1 vit që kanë dalë nga garancioni. Ne e cilësojmë si shume të rëndësishme pjesën e sistemit të ftohjes së mjeteve tona pasi dhe nga eksperienca që kemi pasur më parë (jo shumë të mirë) kemi kuptuar që antifriza krijon shumë korrozion duke na dëmtuar sidomos motorët e aluminit që përkatësisht në flotën tonë e kanë disa mjete , Man , Skoda , Renault, Scania etj. Gjithsesi nuk I kemi kërkuar aprovimet për të gjitha duke marrë parasysh edhe vendimet e OSHP nr. 810/20 për të mos bërë diskriminim me ofertuesit dhe te rritet konkurrenca. Prandaj vazhdojmë të cilësojmë si të rëndësishme aprovimin qoftë edhe nga një prodhues.

Për shkak të logjistikes dhe vështirësive të hasura nga e kaluara, jemi munduar që të zgjedhim një ambalazh sa me komod dhe të përshtatshëm për ndërmarrjen tonë. Flota jonë është gjatë gjithë kohës në lëvizje dhe avaritë teknike mund të jenë kudo. Na ka ndodhur shpesh-herë që na është derdhur vaj rrugëve për shkak te tapave jo të sigurta. Prandaj, mendojmë se nuk duhet hequr fare kjo si specifik pasi për ne është e rëndësishme në logjistikë, por siç e ka thënë edhe eksperti mund t'a kërkojmë që: "Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë ose duhet të ketë një tape të vetme e pajisur me puthitës", përpos yndyrës për të cilën edhe mund t'a shmangim si kërkesë.

Ne flotën tone kemi Ford dhe Fiat disa, nëse është e nevojshme ju dërgojmë dhe listën por meqë kjo bie ndesh me vendimin e OSHP-së nr. 510/20, atëherë këto specifikime nga prodhuesi , MB229.51, FORD WSS-M2C917-A, FIAT 9.55535-S2, FIAT 9.55535-GH2, i zhvendosim në ankesin 1 nga kolona Aprovimet tek Kolona Specifikimet . Pra, produkti duhet të përputhet me specifikimet më sipër.

Edhe në lidhje me pretendimin nr. 4 të OE, mund të bëjmë një tolerim dhe mund t'a zhvendosim tek aneksi 1 nga Kolona Aprovimet tek Kolona Specifikimet MAN TL 283 dhe MB 264.0. Në këtë mënyrë edhe operatori ekonomik të kuptoj se nuk është bërë asnjë diskriminim por vetëm kërkohet më e mira për makinat tona.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:

Konfirmojmë pranimin e mendimit të ekspertit dhe me këtë rast pajtohemi pjesërisht me mendimin e tij. Një detaj që duhet të sqarohet është se eksperti për pretendimin nr. 1, emërtimit SKODA TL 774 D dhe

SKODA TL 774 F i referohet si specifikacion teknik, por në fakt sipas AK kërkohet aprovim dhe pikërisht mbi këtë bazë ka qenë edhe ankesa jonë, pra të kërkohen specifika por jo aprovimi nga SKODA, pra në këtë rast është e logjikshme të kërkohet specifika TL 774 F por duhet të largohet aprovimi nga SKODA, aq me tepër që specifikacioni TL 774-F është kërkesë e prodhuesit VolksWagen ndërsa SKODA vetëm i ndjek specifikacionet nga VolksWagen. Edhe pretendimi nr. 4 për yndyrë lubrifikuese, të kërkohen aprovime është e panevojshme dhe pothuajse shumë rrallë e kërkuar. Sa për informacion, tek industria e vajrave dhe lubrifikanteve, cilësinë e produktit e përcaktojnë specifikimet teknike si: ACEA, API, ISO, DIN, etj., dhe parametrat fiziko-kimik (siç janë: temperatura e përdorimit, viskoziteti kinematik, indeksi i viskozitetit, dendësia, pika e ndezjes, pika e ngurtësimit, etj).

Ju njoftojmë që ne si OE bëjmë furnizimin me vajra shumë AK të ngjashme në Republikën e Kosovës, po ashtu edhe këtë AK ne e kemi furnizuar deri më tani për disa vite dhe asnjëherë nuk kemi pasur asnjë ankesë rreth cilësisë së produkteve, përkundrazi kemi marr referenca pozitive. Kërkesa e tepërt e aprovimeve te panevojshëm është diskriminuese dhe vetëm sa e vështirëson një aktivitet prokurimi deri në finalizimin e tij.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. -Ferizaj për produktin nr. 10, Antifriz G-12, AK ka kërkuar aprovim nga SHKODA, kërkesë e cila vetëm për një laik nuk nënkupton se është kërkesë e panevojshme dhe diskriminuese. Me sa kemi njohuri nga kontratat për furnizimet e mëhershme, pjesa dërmuese e automjeteve që AK posedon janë kamiona për bartjen e mbeturinave dhe marka SHKODA nuk ka të bëj absolutikisht me pajisjet që posedon AK.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues në aneksin 1 për pozicionin 10, është:

10 - ANTIFRIZ KONCETRAT (PAKETIMI 1 DERI NE 10 LIT LITER) G-12+ (Afati i prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar në ambalazhim. Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë)

- Litër
- (G12+)SAE J1034 JASO M325
- SKODA TL 774 D SKODA TL 774 F

Antifrizi G-12+ përdoret për motor me ftohje me ujë, në temperatura të larta dhe të ulta, ofrojnë mbrojtje të mirë antikorodive, ruajte të mire të pompës së ujit, puthitësve, etj.

Skema e antifrizëve është lami në vete, mirëpo më së lehti identifikohen edhe në bazë të normave G11, G12, G12+ etj.

G11- përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 1980-1997 .

G12 - përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 1997-2008.

G12+ përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 2008, Prezent .

G13- përdoret për vetura të lehta dhe të rënda, vitet 2008, Prezent .

Specifikim teknik i kërkuar për pozicioni 10- Kolana(SPECIFICATION) SKODA TL 774 D, SKODA TL 774 F, janë shifra të prodhuesit Volks Wagen, prodhues i cili mbërthen në vete prodhuesit të tjerë siç janë Skoda, Audi, Bugati, Lamborghini, Seat, Porshe dhe makineri të renda MAN dhe SCANIA. Po ashtu te pozicioni 10 – Specifikacioni SKODA TL 774D mund të largohet nga specifikacioni pasi që këtë e mbulon SKODA TL 774 F. Antifrizi i cili i përmbushë kërkesat e VË TL 774D dhe TL 774F është i barabartë me kërkesat e MAN M324 dhe MB325, ndërsa aprovimi i produktit siguron që produkti të jetë I kualitetit të duhur dhe është produkt mjaft ordiner që shumë prodhues e posedojnë. Andaj pretendimi i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. –Ferizaj, se fakti tjetër diskriminues dhe i pa arritshëm është se për secilin produkt ka kërkuar: Afati I prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar në ambalazhim nga prodhuesi. Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë. Është absurd të kërkohet që produkti të ketë tape të dyfishtë kur pothuajse asnjë prodhues nuk aplikon tape të dyfishtë për ambalazhimet e tyre në paketim 10L ose me çfarë logjike është kërkuar këtë kriter për yndyrë kur dihet se yndyra zakonisht ofrohet në kanta metali ose plastike dhe tapa e dyfishtë është e pa arritshme për thuajse të gjithë prodhuesit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se duke marrë parasysh që shumë prodhues nga regjioni i EU-së, ambalazhet në bidonë plastike prej kapacitetit 10 litër e më lartë, i cilësojnë si ambalazhe industrial, dhe për të njëjtin përdoret me një tape të vetme dhe janë të pajisur me puthitës, pra kjo ofron siguri të lartë për rrjedhje, transport etj. Autoriteti Kontraktues në aneksin 1 specifikime teknike të detyrueshme, të kolona "Përshkrimi i shkurtë" për të gjitha pozicionet , 1 deri 16 të korrigjohet dhe të

largohet " Produkti duhet të ketë tape të dyfishtë". Andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. –Ferizaj që ka të beje me pozicionin 5 Vajmotori SAE 5W-40 janë kërkuar 4 aprovime, MB 229.51, Ford WSSM2C917-A, Fiat 9.55535-S2 dhe Fiat 9.955535-H2. Është e palogjikshme që për një produkt të vetëm të kërkohen aprovime nga shumë prodhues të automjeteve Mercedes Ford, Fiat. Nëse hulumtohen certifikatat e prodhuesve më të njohur botëror të vajrave, për vajin me gradacion 5W-40 teksa njëri prodhues nuk mund të gjendet ndonjë produkt i cili ka shumë aprovime për të njëjtin produkt (bashkangjitur disa nga certifikatat e prodhuesve Castrol, Shell e Texaco ku çartë shihet se asnjëri nuk i ka të gjitha 4 aprovimet që I keni kërkuar për vajin SAE 5Ë40).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar vendimin e OSHP-se me nr. 510/20. Pra, Autoriteti kontraktues të aneksi 1 specifikime teknike të detyrueshme të kolona "APPROVALS" të korrigjojë dhe të largojë numrin e madhe të aprovimeve për një produkt të kërkohet 1 eventualisht 2 aprovime për produkt. Po ashtu, Autoriteti kontraktues të korrigjojë ankesin 1 dhe të kërkon aprovime vetëm për mjete të cilat i posedon. Andaj pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ballkan Petrol" SH.P.K. –Ferizaj që ka të beje me pozicionin nr. 11, yndyrë për lubrifikim, është kërkuar aprovim nga MAN dhe MB. Gjatë përvojës shumë vjeçare, asnjëherë nuk kemi pasur rast që një AK të kërkon aprovime për yndyrë siç është vepruar me këtë rast. Ky është edhe një dëshmi shtesë se po favorizohet një prodhues të caktuar. Ky kriter është tërësisht i panevojshëm dhe diskriminues për shumë prodhues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në aneksin 1 për pozicionin 11, është kërkuar :11.YNDYRË PËR LUBRIFIKIM E HOLLË NLGI - 00(PAKETIMI 1 DERI NE 18 kg) Afati I prodhimit jo më vonë se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar ne ambalazhim nga prodhuesi. Produkti duhet të ketë tape te dyfishtë kg Litium-Kalcium gjysmë fluide për lyerje automatike KP00K-40/ NLGI - Class 00.

Temp -40 grade ne +120 grade celsius

MAN TL 283 dhe MB 264.0 Është e drejtë e Autoriteti kontraktues të kërkojë që YNDYRË PËR LUBRIFIKIM të jetë e aprovuar nga MAN apo prodhuesi Mercedes, për aq kohë sa përdorimi i fundit i yndyrës është në mjetet e paraqitura në kërkesë. Aprovimi për YNDYRË PËR LUBRIFIKIM kërkohet për të garantuar arritjen e kualitetit e cilësisë dhe kërkesave nga MAN dhe MB. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit teknik konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit ka caktuar kërkesa të cilat do të ndikonin në reduktimin apo eliminimin e konkurrencës në kundërshtim me nenit 7 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që konform nenit 53.7 të LPP-së të zgjas afatin për ofertë dhe ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe njëherit duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- K.R.M. Pastrimi" SH.A

1x1 OE –"Ballkan Petrol" SH.P.K. – Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.